



Qendra për Arsim e Kosovës  
Kosova Education Center

Kodi: 001

**KEC**

## **PLANI ZHVILLIMOR I SHKOLLËS**

### Qëllimet e Programit

Me përvetësimin e këtij Programi pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje:

- T'i shpjegojnë nocionet themelore të planifikimit.
- Të demonstrojnë dije dhe aftësi interpretimi të problemeve të ndryshme që lidhen me planifikimin.
- Të përshkruajnë në hollësi qëllimin e planifikimit në përgjithësi dhe të Planifikimit Zhvillimor - PZH në veçanti.
- Të formulojnë drejt vizionet zhvillimore, qëllimet, prioritetet si dhe të shpjegojnë ndërlidhjet e tyre me vlerat dhe ndryshimet e ndodhura.
- Të koordinojnë procesin e Planifikimit Zhvillimor të shkollës, duke inkorporuar komunitetin arsimor.
- Të konstatojnë ndërlidhjet ndërmjet prioritetëve – aktiviteteve, të qëllimeve dhe të vizioneve të arritura.
- Të përdorin metoda, teknika dhe procedura të ndryshme për përpilimin, zbatimin dhe vlerësimin e zbatimit të planit si dhe për konstatimin e suksesit.

### Përmbajtja

Koncepti i planit të zhvillimit të shkollës. Etapat e përgatitjes së planit të zhvillimit të shkollës, Llojet e planeve të zhvillimit të shkollës. Formimi i ekipit për përpilimin e planit të zhvillimit. Revizioni në shkollë. Instrumentet e revizionit, format dhe ndarja e roleve në revizion. Përgatitja e raporteve. Prioritetet. Llojet e prioritetëve. Definimi i prioritetëve. Krijimi i një liste të prioritetëve. Përpilimi i planit të zhvillimit të shkollës. Struktura e tij. Përpilimi i planeve aksionale. Zbatimi i planit në praktikë. Qëllimet dhe

vlerat e shkollës. Arsyetimi i prioritetëve. Planifikimi kohor i prioritetëve. Planifikimi i finanacave.

#### Grupi i synuar

Ky program i dedikohet të punësuarve në administratën arsimore, mësimdhënësve dhe pjesëtarëve të komunitetit shkollor, si dhe të gjithë atyre që tregojnë interesim për të zotëruar teknikat e përgatitjes të planit zhvillimor të shkollës.

#### Forma e organizimit/Kohëzgjatja

Programi organizohet në formë të një seminari 2-ditor, i cili pasohet nga një punëtori 1-ditore që i kushtohet këmbimit të përvojave të pjesëmarrësve në hartimin e planeve zhvillimore.

Programi ka gjithsej **24 orë**.

#### Certifikimi

Kusht për certifikim është pjesëmarrja mbi 75% në seminar dhe në punëtori, si dhe kryerja e detyrave të dhëna.